



BASHKIA TIRANË

QENDRA EKONOMIKE E ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE



Zhvillimi Gjuhësor tek Fëmijët
0 - 3 vjeç

Teknika të Stimulimit Gjuhësor

Migena Mastori

Erminda Banushi

Janar, 2019
Tiranë

© Ky material është produkt i specialistëve të Sektorit të Kujdesit dhe Zhvillimit Psiko-Social në Qendrën Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit, Bashkia Tiranë.

Materiali mbi “Zhvillimin Gjuhësor të Fëmijëve 0-3 vjeç” është hartuar për t’i ardhur në ndihmë prindërve, fëmijët e të cilëve frekuentojnë çerdhet publike në qytetin e Tiranës. Materiali paraqet informacion me qëllim që prindërit të kuptojnë më mirë se çfarë është zhvillimi gjuhësor, sa i rëndësishëm është ai kur nis në kohën e duhur tek fëmijët, si mund ta stimulojnë atë etj.

Materiali mund të përdoret nga specialistët e sektorit, punonjës socialë dhe psikologë, nga stafi edukator i çerdheve publike për të shtuar më tej njohuritë e tyre mbi këtë fushë të zhvillimit, si duhet të punojnë dhe stimulojnë zhvillimin gjuhësor kur fëmijët paraqesin vështirësi.

Hartimi i Materialit:

Msc. Migena Mastori

Punonjëse sociale

Erminda Banushi

Punonjëse sociale

Paraqitja kompjuterike, ilustrimi, redaktimi:

Msc. Migena Mastori

Tiranë, 2019

Përmbajtja

Hyrja	fq. 4
Teoritë e zhvillimit gjuhësor-Statet	fq. 6
Elementë që karakterizojnë gjuhën	fq. 7
Komunikimi	fq. 8
Zhvillimi i gjuhës dhe të folurit – Karakteristikat moshore	fq. 10
Teknika të stimulimit gjuhësor në ndihmë të prindërve	fq. 12
Rëndësia e Leximit të Librave për Fëmijët në Zhvillimin e Gjuhës	fq. 14
Për Stafin Edukator – Këshilla	fq. 15
Bashkëpunimi Prind - Edukator – Staf Mbështetës	fq. 16
Bibliografia	fq. 17

Hyrja

“Asnjë njeri nuk është një ishull”

Fëmijët mësojnë për veten e tyre dhe botën që i rrethon përmes komunikimit apo ndërveprimit. Ndër vite shumë teori dhe analiza shkencore janë formuluar duke nxjerrë në pah rëndësinë e gjuhës, gadishmërinë dhe rëndësinë e komunikimit mes fëmijës, prindit dhe të rriturve të tjerë. Vitet e para të jetës janë mjaft kritike për zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës, pasi aty vendosen themelet për fitimin e aftësive që ndikojnë në të mësuarin, shëndetin, sjelljen dhe komunikimin.

Fëmija në këtë moshë është si një motor, me shumë energji, entuziazëm dhe kuriozitet. Gjatë vitit të dytë të jetës rritja nuk është më aq e ndjeshme siç ndodh në vitin e parë, ai rritet më ngadalë por në zhvillimin e tij nisnin të ndodhin ndryshime të rëndësishme. Këtë stad ai e nis me aftësitë, tiparet e një foshnje duke përfunduar me ato të një fëmije të vogël. Fitimi i shkathtësisë në lëvizje i lejon ata të eksplorojnë botën rreth tyre. Ndërkohë zhvillimi i shpejtë i të folurit dhe gjuhës, shtimi dhe pasurimi i fjalorit i ndihmon ata të mendojnë dhe mësojnë në mënyrë më komplekse.

Ata bëhen fjalëshumë dhe aktivë, duke ndaluar ndoshta vetëm në kohën e ushqimit dhe të gjumit. Kurioziteti dhe pyetjet e tyre shtohen, ndërsa nivelet e energjisë duken të pafundme.

“Ë dashur prindër, edukatorë dhe profesionistë: ky material ka për qëllim t’ju ndihmojë sadopak të kuptoni rëndësinë e gjuhës dhe të komunikimit me fëmijët, si duhet të ndryshoni sjellje apo qëndrime tuajat për t’i dhënë atyre mundësinë të flasnin dhe komunikojnë drejt. Zhvillimi gjuhësor është komponent mjaft i rëndësishëm në tërësinë e një fëmije prandaj duhet të përpiqemi të krijojmë një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurtë që e stimulon dhe nxit atë”

1. Të mësosh të flasësh!!!!

Vitet e para të jetës shoqërohen me procese të furishme të të mësuarit. Nga të gjitha zhvillimet që një fëmijë përjeton gjatë tre viteve të para të jetës së tij, ajo çka bie më shumë në sy është zhvillimi fizik, zotërimi gjithnjë e më shumë i trupit. Por paralelisht ndodh edhe zhvillimi i të folurit. Para syve të prindërve dhe të rriturve të tjerë rrotull fëmijës ndodh “një mrekulli” – pas belbëzimeve të një foshnje disa muajshe, brenda 2-3 viteve tek fëmija zhvillohet një gjuhë e kuptueshme. Foshnjat dhe fëmijët kanë nevojë të jenë pranë prindërve, njerëzve të rritur për mësimin dhe përvetësimin e gjuhës, prandaj bashkëveprimi social në këtë proces është element thelbësor shoqëruar me përforcimin (Skinner-Teoria Bihejvioriste). Sipas tij, gjuha mësohet përmes imitimit, kushtëzimit, përforcimeve të dhëna nga prindërit dhe kontakti i gjerë me mjedisin. Kur prindërit, kujdestarët reagojnë ndaj belbëzimit të foshnjës me buzëqeshje apo vokaliza, fëmijët vazhdojnë të belbëzojnë edhe më shumë. Shumë studime kanë treguar sesa më shumë që nëna i përgjigjet vokalizave të foshnjave të tyre, aq më shpejt ato do ta mësojnë gjuhën.

Të folurit (si proces) dhe të kuptuarit e të folurit shkojnë dorë për dorë. Duke dëgjuar të tjerët, fëmija mëson se si fjalët tingëllojnë dhe si ti vendosë ato së bashku. Ata e zhvillojnë të folurin në faza, dhe mund të arrijnë në ato faza në kohë të ndryshme.

Çfarë është gjuha?

Përmes gjuhës, njerëzit komunikojnë, përcjellin mesazhe, shprehin ide për veten dhe të tjerët. Përmes gjuhës dhe simboleve të saj ne kemi mundësi të shprehim mendimet tona, të flasim për të tashmen dhe të ardhmen. Gjuha mësohet duke e dëgjuar dhe duke e folur. Ky proces zhvillohet së tepërmi kur të rriturit inkurajojnë dhe mbështetin përpjekjet e fëmijës për t'u shprehur. Kur flitet për gjuhën dhe komunikimin te fëmija, duhet të dimë që kemi të bëjmë me një proces kompleks që përfshin të paktën tri sisteme: “Fëmija, Gjuha dhe Mësimi i saj”.

1.1 Teoritë mbi Zhvillimin Gjuhësor - Stadet

Gjuha fillon që nga lindja. Kur lindin foshnjat parapëlqejnë zërin e një të njohuri ndaj zërit të një panjohuri. Para se të shqiptojnë fjalët, foshnjat dhe fëmijët komunikojnë përmes shprehjeve të fytyrës, lëvizjeve trupore, gugatjeve dhe britmave. Kjo vijon deri në momentin kur fillojnë të flasin. Referuar studimeve(viti 1971) nga studiuesit dhe psikolinguistët(Kaplan& Kaplan) u përcaktuan disa stade të krijimit të tingujve gjatë vitit të parë të jetës. Sipas tyre gjuha është komplekse dhe është e pamundur që një fëmijë ta përvetsonte atë vetëm përmes imitimit. Ata arritën në konkluzionin se fëmijët janë të programuar biologjikisht për ta përvetsuar gjuhën.



Stadi i parë ⇨ bebet fillojnë të qajnë gjatë lindjes.

Stadi i dytë ⇨ nis në muajin i dytë ⇨ gugatja.

Stadi i tretë ⇨ nis në muajin e gjashtë ⇨ belbëzimi.


Stadi i katërt ⇨ mosha 1-vjeçare⇨ lindja e modelit të të folurit.

Stadi i pestë ⇨ mosha 2-vjeare ⇨ zhvillimi gjuhësor

karakterizohet nga të folurit telegrafik, me dy fjalë p.sh. “babi im”. Në moshën 3-4 vjeçare fjalitë bëhen më komplekse dhe fëmijët përdorin kohën e shkuar.

Gjatë zhvillimit, gjuha është e rëndësishme në vetë-rregullim, pasi fëmija përdor të folurin e tij për të kontrolluar sjelljen. Gjuha ka impakt në të gjitha aspektet e zhvillimit kognitiv, social, emocional. Kur rriten dhe shtohen aftësitë gjuhësore është më e lehtë të arsyetosh me fëmijën dhe t’i shpjegosh sjelljet e dëshiruara sociale dhe anasjelltas. Duke përsosur aftësitë gjuhësore, fëmija përjeton më pak ndrydhje, është më pak i tërhequr dhe shpjegon si ndjehet apo çfarë kërkon. Në të kundërt boshllëku midis të kuptuarit të dhe aftësisë për të shprehur atë që duan, është si shkak i ndrydhjes dhe ndonjëherë çon në probleme sjellore.


1.2 Elementë që karakterizojnë Gjuhën



Fjalori- Ne e nisim procesin e të mësuarit të fjalorit në fëmijëri dhe mësojmë përmes të dëgjuarit dhe vëzhgimit të prindërve kur na flasin. Foshnjat dhe fëmijët e mësojnë kuptimin e fjalëve kur i dëgjojnë të përdoren në situatat e përditshme. Kur ata kuptojnë se çdo gjë ka një emërtim, futen në procesin e të nxënimit aktiv dhe tregojnë me gisht në mënyrë që i rrituri t'i thotë emrin. Më pas nisin të bashkojnë fjalët në fjali.



Gramatika- Nëse fëmijët zotërojnë një fjalor prej 200 -220 fjalësh dhe mund të lidhin 2-3 bashkë, atyre duhet t'i mësojmë gramatikën e gjuhës që përfshin të mësuarin sesi duhet t'i thotë gjërat në shumës apo duke përdorur rregullin e vendosjes së fjalës në fjali.



Ligjëratë- Për t'u shprehur dhe për t'u kuptuar fëmijët duhet të prodhojnë ligjëratë të qartë e cila përfshin aftësinë për t'i bashkuar tingujt dhe vendosur në fjali, përdorimin e intonacionit, theksimin e fjalëve dhe kontrollin e shpejtësisë në të folur. Këto quhen aftësitë motorike të ligjëratës.



Gjuha e shenjave-Fëmijët mësojnë më shpejt fjalë të reja nëse shohin një pamje, vizatim, pikturë që e ilustron fjalën dhe në të njëjtën kohë ta dëgjojnë atë. Të dhënat vizive ndihmojnë në memorizimin e fjalëve. Përdorimi i shenjave dhe fjalëve në të njëjtën kohë gjatë vitit të parë të jetës e ndihmon fëmijën të kuptojë më shpejt fjalët dhe të aftësohet në komunikim. Studimet kanë treguar se fëmijët që komunikojnë përmes shenjave kanë fjalor më të pasur në

moshën parashkollore. Gjuha e shenjave duhet të jetë një urë për të folur duke ecur në mënyrë paralele për të zhvilluar më tej ligjëratën.


1.2.1 Komunikimi si Proçes



“McLuhan & Ong(studiuues) - e kanë parë artin e komunikimit në optikën e rezultatit që përfitohet nga praktikimi i saktë i tij. Komunikimi kthehet jo më në aftësinë e përçimit të një mesazhi, por në përçimin e tij në mënyrë të tillë që personit të cilit i drejtohem të sillet ashtu siç ne dëshirojmë. Ky aspekt ja vlen të shqyrtohet thellësisht për sa kohë që na mundëson të përmirësojmë marrëdhëniet ndër njerëzore”.

Komunikimi- Nis kur bebja qesh/buzëqesh me prindërit, bëlbëzon me ta duke i parë si model. Foshnjat nisin të zhvillojnë aftësitë e komunikimit në muajt e parë të jetës duke i përsosur dhe përdorur në pjesën tjetër të saj. Komunikimi është proçes i gjerë i cili i referohet mënyrave përmes të cilit ne përcjellim informacion në cilësinë e marrjes dhe dhënies. Kjo realizohet përmes formës verbale si: përdorimi i fjalëve dhe fjalive për të dërguar mesazhin në mënyrë që dëgjuesi ta kuptojë dhe asaj joverbale si: gjestet, shprehjet faciale etj. Komunikimi përfshin të mësuarin për të marrë rradhën, për të dëgjuar dikë, për të vendosur kontaktin me sy. Fëmijët në përgjithësi janë komunikues të mirë. Edhe pse të folurit zhvillohet më ngadalë ata janë të aftë në marrjen e informacionit pasi vendosin kontaktin me sy, kuptojnë komunikimin joverbal, përdorin gjestet.

1.2.2 Stili i Prindërimit në Zhvillimin e Gjuhës



Vëmendja ndaj asaj që thotë fëmija duke parë nëse është në harmoni me kontekstin e saj.

Vëmendja ndaj mënyrës sesi flet fëmija, por jo duke i mëshuar me forcë gabimeve të tyre.

Krijojini mundësi fëmijës të kuptojë se gjuha dhe komunikimi është kënaqësi, dëshirë dhe domosdoshmëri.

- Studimet e ndryshme të kryera ndër vite kanë treguar se zhvillimi gjuhësor i fëmijëve, prindërit e të cilëve ju adresohen apo përgjigjen më shpesh, kanë një fjalor më të pasur dhe më të shpejtë në rritje, si dhe koeficient inteligjence më të lartë, sesa ata fëmijë, të cilëve prindërit u flasin më pak.
- Prindërit, të cilët në gjuhën e tyre përdorin fjalë dhe fjali të ndryshme e ndihmojnë fëmijën të jetë divers në krijimin e fjalorit të tij/saj(emrat, mbiemrat, përemrat).
- Korelacioni midis feedbackut pozitiv dhe negativ - Të vegjlit që dëgjojnë më shpesh “jo, mos, stop” apo ndalesa të tjera ngjashme kanë aftësi më të varfra gjuhësore sesa tre vjeçarët që inkurajohen dhe marrin përgjigje pozitive nga prindërit p.sh. përsëritja e tingujve, ndjekja me pyetje, afirmime etj.
- Fëmijët e prindërve, që ju flasin më shumë 3 vitet e para të jetës, kur shkojnë në shkollë fillore japin rezultate më të mira në aftësi të ndryshme gjuhësore si p.sh. leximi, shqiptimi, të folurit dhe aftësi për të dëgjuar.
- **Vëmendje!!!** Koha e banjës është një moment i natyrshëm dhe i përshtatshëm për stimulimin e të folurit. Emërtimi pjesëve të trupit p.sh. “Tani po lajmë dorën, këmbën etj” merr rëndësi. Për foshnjat imitimi i gugatjeve, belbëzimeve, shprehjeve të fytyrës nxit ndërveprimin para-gjuhësor duke e bërë këtë proces më të këndshëm.

2. Zhvillimi i Gjuhës dhe të Folurit – Karakteristikat Moshore

Paraqitja e karakteristikave të zhvillimit të gjuhës sipas muajve/ Viti

Paraqitja ne tabelë

Mosha	Karakteristikat e gjuhës tek fëmijët
0-4 muaj Komunikimi i Hershëm	<ul style="list-style-type: none">▪ Belbëzon / gugat kur dikush i flet ose buzëqesh.▪ Gugat duke përdorur tinguj si ah, eh, uh...imiton tingujt e vet ose pasthirrma të të tjerëve.▪ Bebi reagon ndaj tingujve, zërit të lartë dhe kthen kokën për të gjetur burimin e tingullit.
4-8 muaj Komunikimi i Hershëm	<ul style="list-style-type: none">▪ Belbëzon duke përsëritur disa rrokje me radhë: ma-ma-ma, ba-ba-ba.▪ Imiton tinguj jo të folur p.sh. kolla, përplasja e buzëve, e gjuhës.▪ I përgjigjet emrit të tij ose kërkesave të thjeshta si p.sh. ha ose bëj paçim.▪ I përgjigjet emrit, u “flet” lodrave.▪ Emocionet si gëzimi, inati i shpreh duke nxjerrë tinguj të ndryshëm.
8-12 muaj Kupton Rutinat	<ul style="list-style-type: none">▪ Kanë kontroll mbi mjedisin prëmes komunikimit. Përdorin shprehjet e fytyrës, sytë, vokalizat, gjuhën e trupit.▪ Përforcimi i rutinave dhe fjalëve që shoqërojnë i bën të duken sikur kuptojnë gjuhën p.sh. ushqimi, fjetja etj.▪ Belbëzon për të hyrë në marrëdhënie me të tjerët ose mund të bërtasë për të tërhequr vëmendjen.▪ Tund kokën për të thënë “po ose “jo”. Nis të thotë da-da, ma-ma.▪ Imiton tingujt që ka mësuar deri tani p.sh. si bën kali, makina,

kolla etj.

- I pëlqen rima, muzika. Nxjerr tingujt, gugat dhe kërcen me muzikë.
- Zgjat lodrën, objekte kur ja kërkojnë me fjalë dhe e shoqëron me gjeste.

12-24 muaj

Fjalët e Para

- Përdor më shumë fjalët në vend të zhurmave vokale.
- Arrin t'i kuptojë fjalët.
- Gjuha e kuptuar është më e zhvilluar se ajo që shprehet .
- Përdor më shumë fjalë duke i vendosur në formë bisede ose formon fjali me dy fjalë "mami paçim".
- Përdor një fjalë për të shprehur një mendim të tërë p.sh. "unë" në vend të "dua dhe unë mollë". Fjalët që thotë kuptohen 20-25 %.
- Përdor mesatarisht 50-300 fjalë të ndryshme dhe fjalori është vazhdimisht në rritje.
- Ka një të folur të veten si kod. Shumë pjesë nga biseda e një 2-vjeçari kanë kuptim vetëm për të.
- I referohet vetes më shumë si "mua" ose "unë" sesa në emër p.sh. "mua po iki".
- Gjen tri pjesë të trupit kur e pyet p.sh. hunda, veshi, goja ose tregon lodra, kafshë, persona kur i kërkohet.
- I përgjigjet pyetjeve të thjeshta me "po, jo" dhe me lëvizje të duhura kokës.
- Shpreh fjali mohuese ose kapet pas një fjale mohuese si "jo", "nuk" p.sh. "jo qumësht".
- Pyet në vazhdimësi "Çfarë është kjo?", përdor fjalë në shumës, tregon sende apo ngjarje që nuk kanë ndodhur tani dhe ky është progres në njohje dhe gjuhë.

24-36 muaj

Vendosja bashkë
e

Fjalëvë

- Fjalori rritet në 300-1000 fjalë. Reciton vjersha me rimë dhe këndon këngë.
 - Të folurit është më i kuptueshëm në shumicën e kohës dhe shprehet me fjali të gjata.
 - Tregon mohim duke vënë "jo, nuk" para një emri ose fraze të thjeshtë p.sh. "jo bebi".
 - Përgjigjet kur e pyesim "çfarë po bën" dhe "ku". Pyetje që lidhen me objekte dhe ngjarje të njohura.
 - Nis të flasë për veprimet e të tjerëve: "mami iku në punë".
 - Bën pyetje në vazhdimësi dhe i përgjigjet pyetjeve të thjeshta në mënyrë të përshtatshme.
 - Bashkohet në përhëndetje të zakonshme "hej", "të lutem".
-

2.1 Teknika të Stimulimit Gjuhësor të Fëmijëve

Për Prindërit!!!

Si të ndihmojmë bebin të flasë? 🗨️

Kur bebi është në fazën e zhvillimit të tij gjuhësor, fjalët për të marrin rëndësi tjetër. Kjo do të përbëjë bazën e të mësuarit të gjuhës: të kuptuarin (zhvillohet më parë) dhe të folurit (më vonë). Prindërit mund të ndihmojnë bebin duke ndjekur disa udhëzime:

- **Flisni ngadalë** - Përpiquni të flisni me fëmijën ngadalë, thjesht duke shqiptuar mirë fjalët. Gjuha dhe të folurit e shpejtë do të vështirësonte punën e tij.
- **Përqendrimi tek fjala** - Kur bisedohet me bebin duhet të vendoset theksi tek fjalët që janë më kuptimplotë në fjali të cilat lidhen edhe me rutina të ditës si p.sh të ngrëni- "do të zbrasim qumështin".


- **Vëmendja për fjalët** – Prindërit duhet të jenë të kujdesshëm ndaj fjalëve të para sepse mund t'i ngatërrojnë me bëlbëzimet p.sh. ba-ba në baba.
- **Komentimi i emrave** – “Ky është libri i mamit dhe ky i Lolës”.
- **Imitoni pas tij** – Nëse bebi bisedon me ju duke thënë ma-ma, ba-ba, duhet të pasohet nga ju me të njëjtat si më lart duke i theksuar më fort. Me kohën mund të shtohen edhe tinguj të tjerë si p.sh. “da-da-da”.
- **Këngë me rimë** – Mund të përsëritet çdo ditë e njëjta këngë. Kjo është gjë e bukur dhe bebi mëson shumë. Është koha kur ai mund të dëgjojë këngë për fëmijë.
- **Përdorni libra** – Edhe pse bebi nuk është akoma gati për të dëgjuar histori, rima e thjeshtë dhe tregimi i figurave e tërheqin vëmendjen e tij. Mund të shtrohen edhe pyetje si p.sh “ku është topi” duke vendosur gishtin në figurë.
- **Jini urdhërues** – Është e rëndësishme për bebin të marrë komanda të thjeshta si p.sh. “bëj paçim”, “puthe mamin”. Kjo e ndihmon të kuptojë dhe të kryejë veprimin.

Si të ndihmojmë fëmijën të flasë? 🐣

- **Emërtoni çdo gjë** – Thoni emrat e të gjithë sendeve në mjedis p.sh. llamba, stoli. Thirreni fëmijën në emër, që të kuptojë se është njeri i veçantë.
- **Dëgjojeni** – Ajo që fëmija do t’ju thotë është po kaq e rëndësishme sa edhe ato që ju i thoni. Edhe nëse se kuptoni fjalën e tij dëgjojeni dhe përgjigjuni p.sh. : “Kjo është mjaft interesante”.
- **Mësojini ngjyrat** – Tregojini ngjyrat duke ja lidhur me gjërat e tij/ e saj p.sh. “Topi është i kuq si bluza jote”.
- **Nxiteni të flasë pas jush** – Përdorni të gjitha marifetet që fëmija të përgjigjet me fjalë ose gjeste. Lëreni të zgjedhë p.sh. “Do bukë apo qumësht”. Lejojeni të tregojë çka dëshiron qoftë edhe me gisht apo sy.
- **Flitini si një i rritur** – Përdorni fjalët e sakta të të rriturve dhe jo ato të të vegjëlve. Kjo e ndihmon të flasë më shpejt.
- **Korrigjoni me kujdes** – Fjalët e një të vogli nuk dalin si tek një i rritur. Shumë bashtingëllore janë mjaft të vështira për t’u përdorur p.sh. “kali – tali”, shumë fjalë

thuhen përgjysmë. Nëse fëmija nuk shqipton mirë mos e korrigjoni si mësues të ashpër – kritikata mund ta pengojnë.

- **Jepni urdhëra të thjeshta** – Fëmijët i ndjekin urdhërat e thjeshta, jepini një e nga një. P.sh. në vend që të thoni “Të lutem merre lugën dhe ma sill ” përpuni të thoni “Të lutem merre lugën”. Këto teknika ndihmojnë të kuptuarin duke nxitur më pas të folur.
- **Muzika dhe të kënduarit** - Shumica e fëmijëve e shijojnë muzikën. Të kënduarit me foshnjat dhe fëmijët e vegjël krijon dashuri për gjuhën. Fjalët e shoqëruara me muzikë janë më të lehta për t’u shprehur dhe për t’u mbajtur mend.
- **Leximi dhe shikimi i librit** - Leximi që ju bëhet fëmijëve është aktiviteti më i rëndësishëm që ndihmon në zhvillimin gjuhësor sepse u jep mundësi të dëgjojnë fjalë të reja dhe të panjohura.



2.2. Rëndësia e Leximit të Librave për Fëmijët në Zhvillimin e Gjuhës

Këshilla të thjeshta për prindërit!!!

Si të lexojmë bashkë me fëmijën?

- Gjatë leximit ndaluni dhe diskutoni mbi figurat e librit p.sh shiko kapelen e arushit.
- Gjatë leximit kërkoni fëmijës të tregojë figurat, sendet, emrat e kafshëve që di ose nuk i mban mend etj.
- Gjatë leximit mund të bëni komente si “këtu ka dy mace, tre zogj” etj. Kjo ndihmon t’i bëni fëmijës dhe pak aritmetikë.
- Bëjeni numërimin pjesë të jetës së fëmijës.

Si të ndihmojmë fëmijën që historinë e librit ta lidhë me ngjarjet e jetës reale?

- Pas leximit, bëhuni aktor duke luajtur personazhe të ngjarjes që treguat.
- Bëni ato që tregohet në libër, vishuni-zhvishtuni, imitoni tinguj, zhurma, kafshë etj.

- Lejojeni fëmijën ta tregojë ngjarjen përmes figurave të librit.
- Lejojeni fëmijën të bëhet si personazhi i librit p.sh. rosaku i vogël, arushi Tedi.
- Shëtitni me fëmijën dhe zgjerojeni historinë duke i treguar dhe në natyrë se çfarë tregon përralla p.sh si u ngjit macja mbi pemë.
- Organizoni bashkë me fëmijën dhe shokë të tij/të saj një koncert të vogël ku të recitojnë vjershat, këngët që u pëlqejnë më shumë.

3. Për Stafin Edukator – Këshilla!!!

Edukatorja është person i rëndësishëm për fëmijën pas prindërve. Psikologët dhe punonjësit socialë në çerdhe ndihmojnë në ngritjen/krijimin e një marrëdhënie besimi mes tyre. Marrëdhënia pozitive edukator-prind e ndihmon fëmijën të ndjehet mirë, duke qenë se njerëzit e rëndësishëm për të punojnë bashkë për mbarëvajtjen e tij/saj.

- Të komunikohet me fëmijët me fjalë/fjali të plotë. Flisni sa më shumë dhe emërtoni sendet/lodrat që fëmija ka përreth. Me rëndësi është përsëritja e termave pasi përmes saj fëmijët memorizojnë më shumë.
- Të flitet/bisedohet me fëmijët për aktivitetet e përditshme në çerdhe duke i përshkruar, duke punuar me fjalë dhe figura. Këto favorizojnë dëshirën e fëmijës për t'u shprehur, zhvillon kapacitetin e tij në njohjen e sa më shumë fjalëve.
- Ushqyerja e kujdesshme, mësimi i ushqimit me lugë në çerdhe nga edukatorja ndihmon shumë në vendosjen në punë të muskujve të të folurit. Emërtimi i ushqimeve dhe përbërësve gjatë procesit p.sh."Supa është me karrota, patate etj." stimulon fillesat e bashkëbisedimit.
- Të përdoret një sistem komunikimi paralel verbal-joverbal p.sh. duart, gjestet, pamjet shoqërojnë gjithmonë me komunikimin verbal. Kjo gjë e ndihmon fëmijën të kuptohet dhe evitohet frustrimi. Kujdes!!! Gjuha verbale duhet të mbetet gjithmonë prioritet.

- Kur vihen re specifika/problematika të orientohen prindërit mbi terapinë logopedike, ushtrime, masazhe që stimulojnë muskujt që përdoren kur flasim(gjuha, muskujt në faqe, nofulla, lëvizjet e buzëve, mimika e fytrës). Ushqyerja me gji dhe me lugë ndihmojnë shumë në vendosjen në punë të muskujve që lidhen me aparatën e të folurit.
- Mbi problematika gjuhësore që mund të shfaqin fëmijët të kërkohen këshilla/orientime nga specialisti psikolog/mjek/stafi mbështetës(në çerdhe).

♣Merrni në konsideratë aktivitete stimuluese në funksion të komunikimit “

-
- Çdo ditë në rrethin e mëngjesit bëni ushtrime të mimikës, bukaturës dhe gjuhës. Të gjithë fëmijëve ju bën mirë pak fiskulturë e bukaturës me lojra gazmore.
 - Qëndroni në kontakt me sy me fëmijën kur komunikoni dhe stimuloni radhën në komunikim dhe lojë.
 - Flisni qartë, ngadalë, kuptueshëm dhe shoqëroni të folurin me shprehje të fytrës dhe gjeste p.sh. figurat, pamjet ndihmojnë shumë.
 - Tregojini fëmijës foto të tij, të familjarëve, të objekteve dhe t'i emërtojë ato.
 - Përdorni motivimin dhe lavdërimin pasi rritet vetëbesimi dhe nxiten më shumë.

3.1 Bashkëpunimi Prind - Edukator – Staf Mbështetës

-
- Të dëgjohen perspektivat e njëri-tjetrit.
 - Ndarja e informacionit për të bashkërenduar të kuptuarin dhe ndërhyrjet tek fëmija.
 - Të respektohen aftësitë dhe njohuritë e secilës palë.
 - Të realizohet vendimarrje e përbashkët rreth programeve specifike dhe aktiviteteve të tjera në çerdhe.
 - Të ndahen rolet dhe detyrat në aplikimin e programeve.
 - Festoni sukseset e përbashkëta.

Bibliografia

UNICEF & Ministria e Shëndetësisë – Arti i rritjes së fëmijëve.

Angela Glenn, Jacquie Cousins, Alicia Helps- Eleminimi i pengesave në të nxënë në moshën e hershme – Save the Children.

Terry F. Pettijohn – Psikologjia- Një hyrje konçize.

Down Syndrome Albania- Kujdesi, edukimi dhe zhvillimi i fëmijëve me SD.

Claudia & Eberhard Muhlan – Udhëzues i madh i familjes.

UNICEF & Instituti Shoqëria e Hapur - Krijimi i Programeve me Fëmijën në Epiqendër – Për foshnja dhe fëmijë 2-3 vjeç.

Migena Mastori - Shprehitë bazë të komunikimit - Tematikë trajnimi.

Zhvillimi Gjuhësor tek fëmijët – Tematikë trajnimi.

Faqe interneti

[https://sq.wikipedia.org/wiki/Gjuha_\(komunikim\)](https://sq.wikipedia.org/wiki/Gjuha_(komunikim))

<https://sq.wikipedia.org/wiki/Foshnja>

http://www.ikub.al/FEMRA_CATEGORY/1202160034/Article-Belbezimi-tek-femijet.aspx

© Figurat, pamjet e përdorura në material janë marrë nga faqe të ndryshme në Internet.

© Migena Mastori, Erminda Banushi

Tiranë, 2019